



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1038/2023
Datë: 22 dhjetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 22 dhjetor 2023, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet Raporti i Komisionit për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, KPK/KATPSH i datës 16 nëntor 2023 për avancimin e dy (2) prokurorëve të Shtetit në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, si në vijim:
 1. Z. Arben Hoti, avancohet nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.
 2. Znj. Fatmire Cacaj, avancohet nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.
- II. Prokurorët e cekur në pikën 1 dhe 2 të paragrafit I të këtij vendimi do të avancohen nga data 15 janar 2024 si dhe për të njëjtit do të hartohen vendime të veçanta dhe të jenë pjesë e dosjes personale të tyre.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të KPK-së;
- NJSHPP;
- Arkivit të KPK-së.